



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 33-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 29.06. 2020, në sallën e kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Xhyzide Rrustemi, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Arif Miftari, anëtar
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi-Hasani
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Albulena Kelmendi, anëtare
20. Alban Salihu, anëtar
21. Afrim Miftari, anëtar
22. Hajdin Bytyqi, anëtar
23. Safete Amerllahu, anëtare
24. Bashkim Budakova, anëtar
25. Ukë Kryeziu, anëtar
26. Ganimete Qeriqi, anëtare
27. Egzona Fazliu, anëtare
28. Arben Salihu, anëtar
29. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
2. Avni Olluri, drejtor i DA
3. Bekim Shabani, drejtor i DEZH-së
4. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
5. Merita Bytyqi, drejtoreshë DSHMS
6. Bestar Ibrahim, zyrtar i teknologjisë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit, hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe ju tha uroj që ju të jeni mirë dhe familjet e juaja.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktiveve nga mbledhja e 31 dhe 32 (e jashtëzakonshme) e kuvendit.
2. Propozim vendim mbi aprovimin e kornizës Afatmesme Buxhetore 2021-2023 .
3. Propozim vendim për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive në funksion të ndërtimit të rrugës unazore në Lipjan
4. Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Lipjanit për parcelat P-71409028-0140-12 dhe P-71409028-01984-5
5. Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Lipjanit për parcelat P-71409028-01049-6

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, pyeti se a ka dikush vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Lulzim Rustemi, kam një propozim që të dalim me një rekomandim në kuvend të gjitha grupet paralemtare për ta kundërshtuar dhomën e specializuar të gjykatës speciale ku me këtë po preket lufta e pastër e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo po e preket esencën e shtetësisë së Kosovës.

Nehat Tërpeza, ne nuk jemi kundër vlerave të luftës por nuk e di sa ne jemi kompetent për këtë çështje.

Bashkim Budakova, edhe ne si grup jemi për propozimin të cilin e dha Luli.

Albulena Kelmendi, une kam kërkuar nga DKA-ja një raport rreth përfundimit të vitit shkollor dhe mesimit online. Do të duhej që në seancat e ardhshme të ketë një raport nga DKA-ja.

Lulzim Rustemi une jam që ky propozim të cilin e dhash të kalojë pasi që po preket lufta e pastër e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Fauz Xhemajli, une pajtohem me parafolën që është prekur shtetësia e Kosovës, por është mirë që të jetë në ndonjë seancë tjetër pasi që edhe vet instancat e larta nuk kanë reaguar.

Shkelzen Bislimi, qendrimi i Lëvizjes Vetvendosje dihet, ata të cilët e kanë votu Gjykatën Speciale le të bëjnë pasojat. Ne jemi kundër një deklarate të përbashkët.

Ganimete Qeriqi, unë mendoj që nuk kemi qka të presim duhet të reagojmë, pasi që po shihet ku edhe vizitat janë anuluar jashtë vendit nga Presidenti dhe Kryeministri.

Daut Azemi, kisha propozuar që të jetë për një seancë tjetër kjo çështje dhe të shohim se si po rrjedhin gjërat.

Fauz Xhemajli, deri më tani nuk kemi deklarata zyrtare nga Presidenti lidhur me këtë çështje andaj kërkoj që të shtyhet për një seancë tjetër.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se rendit të ditës po e propozoj ashtu siç e keni marrë.

Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për votoi rendin e ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit ,por kërkojë nga ana juaj që të respektoni Rregulloren e punës së Kuvendit,pasi që ishte kërksë nga ju që të jenë diskutimet sa më të shkurta.

Shkëlzen Bislimi, rastet me COVID-19 po shtohen por ajo qka është shqetësuese për qytetarët është se nuk po janë të informuar se kush mund të jetë i prekur nga kz virus.Po ashtu kërkojë nga inspekcioni dhe policia të ndërmarrë masa pasi që nuk po respektohen masat nga qytetarët as distanca fizike e as përdorimi i maskave.

Egzona Fazlija,edhe unë pajtohem me parafolësin që Komuna të informoj qytetarët të paktën në cilat fshatra apo lagje kemi të infektuarit me COVID-19.Po ashtu e falenderojë shtabin emergjent për punën të cilën po e bënë.

Daut Azemi,është e ndaluar me ligj që të identifikohen rastet të cilat janë të indentifikuara.

Albulen Kelmendi,kam dy qështje për ti ngritur e para ka të bëjë me shqetsimin e banorëve të fshatit Gllgovc per shkatrimin e trotuarit ne nje pjesë të rrugës në hyrje të fshatit,ku ata qytetar kerkojë sanimin e ati trotuari.Qeshtja e dzte ka te bëjë me terasat e kafiterive ti cilait i rrisin të hyrat vetanake mirëpo sheshi është bllokuar nga dy kafiteri dhe qytatarët po e kan problem me dalë në shesh,kërkoj nga inspektorati të ndërmarr ndonjë veprim.

Alban Salihu,do ta ngris një qështje rreth zhurmes në kafiteri,ku kërkoj nga inspekcioni të ketë kujdes gjatë inspektimit mos te bëjë diskiminim po të ketë qasje të barabartë per të gjithë njejt.

Lulzim Rrustemi,i kam dy pyetje për ti ngritur e para ka të bej rreth nje pronë publike të cilen e kemi dhanë në shfytzim para dy viteve përball shkollës fillore Emin Duraku në banullë,nuk e dim si është gjendja ku aty ka pase me u ndërtu një fabrikë e këpurdhave deri ku ka shku ndërtimi në cilën fazë është dhe çka ka mbrii komuna perms ati projekti.Pyetja tjetër te prona ku po ndërtohet salla e sporteve pronë komunale aty ka pase me u ndërtu për kategoritë e dala nga lufta me u dhanë me kosnesion.kisha dashtë një shaqrim rreth këtyre pronave.

Lumturije Bytyqi,kam një pyetje për kryesuesin e shtabit emergjent pasi qe gjatë kontakteve me familjart e përsoneve të prekur thuhet se asnjëhere nuk jan kontaktuar nga shtabi emergjent dhe ktëta përsone kan nvë vendim për izolim nga inspektoriati prej 14 ditë dhe ata nuk mujn me dal me ikrz punë as për nevojat e tyre elemntare.

Do të ishte mië qe komuna të i detyroj prinërit qe fëmijet e tyre të i regjistrojnë ne vendet e tyre,ay ku janë banorë rezident nëse ai fshat e ka shkollën e vet siç është rasti i banorve t fshatit Marevc të cilët i qojnë femijet e tyre ne Llugaxhi.

Ramiz Qeriqi,une kam një shqtësim ka një kohë të gjatë qe nuk po ndëgjohet zëri i shoqërisë civile,pom me duket qe qenka një projekt Rilad i cili ua ka ndal zërin,po ashtu po dzshoj qe këtu ka gisht edhe qeverisja,kisha pas dëshirë me ditë pse ata kanë hesht,nuk po monitorojnë fare e më herët kan monitoru.Tjetra ka të bëjë me kompaninë e miërmbytjes së parqeve e cila kisha kërku qe të inspektohet.

Daut Azemi, për shoqëritë civile nuk pzetet as egyekutivi e as legjislativi ata vendosin vet si të veprojnë është e drejtë e tyre.

Ramiz Qeriqi,projektet të cilat i marrin këto OJQ pzetet Komuna janë personat e juaj të cilët i vlersojnë e me i marrë ose jo ato projkete.

Daut Azemi,shoqërite civile aoplikojnë në projektet e tyre dhe nuk mundet komuna me i aktivizu ose me i deaktivizu OJQ-t,ata vet aktivizohen ose deaktivizohen.

Argjent Tasholli,kam për ti ngritur disa qeshtje, a jeni në dijeni se në disa lagje në Gadime nuk jan vendosur ende numrat e shtëpive siç janë lagjja Beka,Zeneli dhe Spahija.Po ashtu te lagja Spahija kemi problem edhe me kanalizim.Fushat sportive të cilat po i ndërtoni ku i keni marrë këto modele.Po ashtu kemi problemim me shportat e mbeturinave ne Gadime,kërkojmë nga puntoret e komapnisë pastrimi qe ti zbrazin shportat e mbeturinave të cilat gjinden afer lumit.Kemi shume vende ne qztetin e Lipjanit

ku jan marre jane vjedhur pusetat kerkoj nga drejtorai perkatëese te ndërmarr hapa dhe ti yavendesoj ato.

Daut Azemi une i kam ftu në këtë mbledhje betëm drejtorët te cilët kanë pika per këtë mbledhje për shkak të situates me Covid-19,por besoj qe do ti marrin pzetjet online dhe do te pergjigjen në seancat e ardhshme.

Bashkim Budakova,kam me ngrit një kërkesë të cilën e kam ngritë edhe në seancat e më hershme,kërkesa ka të bëjë nga banorët e fshatrave Rubofc i Madh,Rubofc i Voglël,Kojskë dhe Llugaxhi të cilët çdo ditë e frekunejtojnë rrugën Rubofc-Lipjan ,te Gllgovci është dëmtuar rruga në pjesën ku është ndërtuar rruga.Kërkohet nga banorët e kësaj ane të bëhet rregullimi i kësaj rruge.

Nazmi Krasniqi,është mirë të dihen të pakten lagjet apo fshatrat e përsoneve të cilët janë të indetifikuar me covid 19

Qështja e dytë ka të bëjë me emrimin dhe riemrimin e rrugëve nëpër fshatra,të kisha lut kryesues qe të ketë një komision.

Fauz Xhemajli,po pajtohena qe nuk po repektohen pasat anti Covid sipas rekomandimit të IKSHP-s.

Nuk mendoj qe ka ndarje në Lipjan sa i përket zhurmës në lokale nuk besoj qe ka ndarje,por ato mund të marrin edhe leje specifike.Sa i përket yenes se sheshit nga disa lokale pajtohna qe dz lokale e kan nxan rrugen.Në Gllgovc kemi probleme pronsore sa i përket asaj rruge.Në krze të shtabit është kryetari dhe ne si shtab besoj qe e kmei krz punen siç është mas miri,nuk mendoj qe ka raste qe nuk ju kemi shërby ne karantine,nuk ka pas ndasi.Sa i përket femijëve në shkolla ne nuk mujna me ndalu asnjë fëmije mos me shku në një shkollë apo në shkollën tjetër.

Alban Salihu,une isha vet dëshmitar ku erdhen policia në njëren kafe për shkak të zhurmës ndërsa në kafen tjetër jo,unë këroj qe të ketë barazi për të gjithë.

Lumturije Bytyqi,ne jemi ende në kohë pandemie,une e di qe dy apo tri familje të cilat janë të prekura dhe nuk kan marrë as një telefonatë nga shtabi.

Fauy Xhemajli, i falemnderoj të gjitha at qe na kan ndihmu në pandemi,ne jemi vlersu si komuna e dyte për menaxhimin e pandemisë,dhe nuk ka pas ndasi,kushdo qe ka qenë i prekur e ka numrin e elefonit pa pagesë per ta kontaktuar shtabin.

Ramiz Qeriqi,është mirë qe nëse është komisioni për emërtimin e rrugëve mu funksionalizu,nëse nuk është funksional kerkoj me u formu një komision tjetër.

Daut Azemi,nuk ka familje qe nuk është kontaktu nga krzetari nënkrzetari apo nga shtabi,shtab janë edhe policia dhe QKMF-ja.Te emrimet e rrugëve është një afat në GPS qe me na u dhanë drita jeshile tani na me fillu.

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja 31 dhe e 32 –të (e jashtëzakonshme) të Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Hyra Bytyqi,ka një gabim teknik ku ende është i shënua emri i Anila Reqices,e cila ka kaluar drejtoreshë,e nuk është shënua ende emri i Xhuzide Rrustemit.kërkoj qe të bëhet ndryshimi në këtë listë

Meqë vërejtje tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktet nga procesverbali i mbledhjes 31 dhe 32 dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për

Aprovoi
Ekstraktet nga mbledhja e 31 dhe 32-të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim vendim mbi aprovimin e kornizës Afatmesme Buxhetore 2021-2023

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, te korniza afatmesme buxhetore deshta një sqarim nga drejtorin cka perfshin subvencione dhe transfere te zyra e kryetarit pasi qe çdo vit bo mëhen mbi 100 mij euro. Ndërtimi i stadionit në Gadime a do të ishte e mundur qe ky projekt të fillonte në vitin 2021 e jo në vitin 2022. Çka do të thotë ndërtim i hpasirave publike sipa jush? Po ashtu kam vërejtje te cilësia e investimeve qe po bëhet në komunën e Lipjanit

Hyra Bytyçi, ne si grup pralamentar i LDK-s jemi pro këtij propozim Vendimi, duke e marr parasyshtë qe kë vendim është obligim ligjor dhe është në përputhje me strategjinë makroekonomike në nivelin qendror, si dhe planit strategjik komunal të komunës së Lipjanit. Ky buxhet është në vija të trasha dhe qytetarët prap mund të vijnë me kërkesat e tyre, siç i kan adresuar edhe më heret.

Nehat Terpeza, e përgzoi egzekutivin per pergaditjen e këtij dokumenti kaq të rëndësishëm për tri vitet e ardhshme. Une dola per të shprehë shqetësimin e banorëve të Ribarit të Madh, lidhur me heqjen e rrugës Ribar i Madh-Ribar i Vogël e cila është votuar në këtë kuvend dhe ka qenë e planifikuar për vitin e ardhshëm. Kërkoj nga ana e juaj ti gjindet një zgjidhje kësaj qështje se është kërkesë e kahershme e banorëve të Ribarit. Shprsoj qe këjo të merret parasyshtë këtë kërkesë dhe kërkesën tjetër renovimin i aneksit të shkollës së vjetër.

Lulzim Rustemi, ka vend shumë për vëretje dhe për përmbushje, një dokumen qe kërkon zgjidhje ma të mira ose propozime ma të mira. Komuna ka dalë me dy kontribute letësia në komunikim dhe llogaridhënja.

Ky buxhet ka rritje të subvencioneve dhe transfereve. Te mallrat dhe shërbimet kemi rritje te shpenzimeve. Te invesimet kapitale ky buxhet më se shumti ka shku në asfatim të rrugicave, nriqim publik e trotuare. Është harru uji i pijshëm, nuk e kemi parapar asnjë invesim rreth ujit të pijshëm, po ashtu kemi investim të vogël në arsim. Edhe në shëndetësi duhet të rriten investimet, në hapsira publike.

Ne kemi edhe vëretje tjera, presim qe do të ketë balacim të projekteve, aty ku ka nevoj emergjente aty le të shkojnë projektet. Po ashtu projektet duhet të jenë specifike dhe të emëtuara, në parim do ta përkrahim këtë propozim. Ky propozim don përmirsim të mëdha.

Latif Ramadani, Te zyra e kryetarit janë ajo shumë e mjeteve sepse gjatë marveshjeve me ndonje organiyate kur po kemi ato mjete ndahen zyra e kryetarit. Nuk e kemi jek rrugën Ribar i Vogël –Ribar i Madh. Këto projekte janë si kërkesë e qytetarëve gjatë 13 degjimeve buxhetore, këta jnaë kufijtë fillesatr deri në shtator mujna me ndryshu.

Kur bëhet ndriqimi publik, rriten edhe shpezimet. Për vitin 2021 për shkak të pandeimsië nuk kena me mutë me i ndryshu kufijtë. Në arsim do te investohet pasi qe kemi marveshje edhe me vervizionin dhe organiyzata tjera, po ashtu edhe në shëndetësi.

Nazmi Krasniqi, nuk duhet të jetë qellimi vetëm më ndërtu ambulanca qerdhe e shkolla po duhet me pa se a po ka njerz për me shku në ato, po ashtu numri i punëtorve. Ne ende nuk kemi arritë me pasë një shkollë ku mbahet mësimi tër ditor. Prioritet duhet me iu dhanë edhe bujqëesiësë.

Ramiz Qeriqi,dola me ju falenderu qe fshati Krojmir për herë të parë është pjesë e këtij projekti,Jam falenderues qe e keni shti në projekt rrugën Shpejtimi,por kisha kërku qe të jeni në bashkpunim me qytetarët e Krojmir po edhe neve dy asambleistëve.

Ukë Kryeziu,une do të ndalëm te shëndetësia ku kisha kërku nga ju qe ti epni rëndësi rreth qështjes së pareve,sepse me para mund të bëhen ndryshimet.Mjetet të cilat i keni nda për shëndetësi kan të bëjnë kryesisht me QKMF-n për paisjet mjekësore dhe blerja e aparaturave për QKMF-n,shumë e cila nuk do të mjafton.Ka nevojë edhe për disa ndërhyrje,siç është pjesa e infuzioneve dhe disa pjesë tjera.Te stamatologjia jo renovim pasi qe renovimi është bërë disa herë ,aty duhet të rrënohet dhe të ndërtohet një objekt i ri.Pulmologjia ne nuk kemi për momentin pulmolog dhe nuk kemi nevojë me renovu por ta bëjmë një objekt të ri të Stamatologjisë.Blerja e automjeteve është shumë e domsdoshme.Shumica e AMF-ve janë jashtë funksionit,për shkak të mungesës së materialit,Disa AMF duhet të kthehen ne QMF, siç është ajo në Sillovi dhe Kraishtë.Në shëndetësi ka nevoj për një organizim tjetër.

Albulea Kelmendi,kjo kornizë buxhetore koncentrimin më të madh e ka në asfalt.

Sa i përket arsimit u pa qe ka një ngritje po përveç poligoneve merimetimit të shkollave ne kemi nevojë edhe për kabinete të tjera siç janë kabineti i komisë.biologjisë,fizikës.Po ashtu përsimirsimi i cilësisë së arsimit.Shqetësuese është puna e ujit të pijshëm,ku nuk kanë fshatrat e as një pjesë e madhe e Lipjanit.

Alban Salihu,ne si asambelsit të VV do të votojmë kundër aprovimit të kornizës afatmesme buxhetore.kjo korniyë është nisë në logjikën e mbrapsht sikur në komunat tjera edhe në komunën tonë beton objekte.Në shëndetësi përmisroni shërbimet.Une ju ksiha lut me i ndrru veprimet pasi qe me veprime të njejta me pritë rrezultatë te ndryshme nuk mundesh.

Nehat Terpeza,nuk e thash pse nuk u hy rruga Ribar i Madh-Ribar i Vogël por pse është hiç ajo rrugë pasi qe ka qenë më herët.

Fehmi Rexhepi,kam per ti ngritur shqetsimet e komunitetit të cilin e përfaqësoj,e para ka të bëjë me qështjen e ujit të pijshëm në Medvec.Qështja e dytë ka të bëjë me rrugën e varrezave të fshatin Hallaq i Vogël,qe është në gjendje të keqe.Kemi një lagje te komunitetit në Magure,e cial ende nuk ka kanalizim.Po ashtu kur do të bëhet regullimi i lumit në Medvec.

Latif Ramadani,në dëgjime buxhetore të cilat i kemi mbajttë ka pasë kërkesë për qerdhe nëpër fshatra.Buxheti planifikohet në bazë të kërkesave të qytetarëve.Ne kemi një marveshje për 10 shkolla për kabinete.Në Krojmir kemi pas çdo herë projekte,po do të ketë edhe investime tjera.E kena parapa qe të riten investimet në shëndetësi dhe në arsim. Uji është duke u investu në bashkpunim me CDI-n.

Në Medvec ka nevoj me u investu edhe në atë lokalitet po do tju vie reni edhe asaj pjese.Sa i përket ujit ato janë probleme teknike.

Rruga në Hallaq të Vogël Gadime dhe Medvec janë për këtë vit në projektet buxhetin e ministrisë.Rruga për Ribar të Madh-Ribar të Vogël nuk ka pajtushmëri mes të dy fshatrave për këtë rrugë.

Nehat Tepreza,une nuk po e di qe ka asi probleme të theksime rreth asaj rruge,por ne jemi dëshmitar qe fshatrat vayhdimisht po lidhen mes vete,ne nuk jemi në dijeni se paska probleme në mes të fshtrave sa i përket asaj rruge.Kjo është kërkesë e qztetarëve rreh asaj rruge.

Ganimete Qeriqi,dola edhe une me falenderu drejtorin për projektet në Krojmir. Albulena i përmendi shumë kabinete po nuk e përmendi kabinetin për kulturën,pasi qe kultura në vendin tonë është bastardhu.Në kohën e kaluar kultura ka qenë më në nivel se sa sot,është mirë qe në të ardhmen të mendohet edhe për kulturën.

Ukë Krzeziu,fjalimet tona nuk janë vetëm koti por fajlimet tona janë qysh e shohim zgjidhjen e problemit,e nuk janë fajlime të kota apo vetm sa për të thanë diçka.

Ramiz Qeriqi,rruga e Shpëtimit e ka një vlerë të veçantë dhe duhet të jetë deri atje ku kan nejtë qytetarët e ka një domethënje të plotë dhe do ta ketë edhe ndihmën time dhe

të qyetatrëve të krojmirit.Sa i përket kulturës është dashtë këtë herë Sefës me i ndihmu për librin e botuar,e besoj qe askush nuk e kish kundërshtu.

Latif Ramadani,ju falemnderoj për kontributin e dhënë,ne jemi mundu me i planifku sa ma mirë të gjitha projektet.Ju ftoj qe në dëgjimet e ardhshme buxhetori të epni kontributin e juaj.Rruga Shpëtimi do te shkoj deri ne fund.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 26 votat për, 2 kundër aprovoi këtë:

Pajstaj u dha pauza prej ores 12:⁰⁰ deri në ora 13:³⁰

Pas pauzes, u kalua në pikën e tretë të rendit të ditës.

III

Propozim vendim për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive në funksion të ndërtimit të rrugës unazore në Lipjan

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Sefer Tashollit, drejtor i DGJK-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Nazmi Krasniqi,e kam një pyetje a është biseduar me pronarët e atyre pronave për shpronsim, a është diskutuar me secilin pronarë?

Hyra Bytyçi,ne si grup parlamentar i LDK-s i kemi analizuar të dy propozimet,ne jemi për propoyimin e dytë pasi qe propozimi i dytë është me kosto me të ulët.

Daut Azemi,buxheti për këtë rrugë është siguruar nga ministria dhe do të ketë debat me banorët e asaj pjese pasi që të shpallet interesi publik.

Lulzim Rrustemi,deri sa këto prona janë kanë të njohura se ka rrugë për qytetarët do te ketë problem ata të cilët kanë ble parcela,tash rruga e re i pren te gjitha pronat ku me këtë qytetarët nuk e dinë qe do të ketë një plan të ri të rrugës dhe kjo është një kosto e re pastaj ky plan i ri nuk mund të bëhet pa debat me qytetarët sepse kta drejtpërdryt atakohen me pronat e tyre të cilat i kanë.Une kam propozim qe te shkon te kshilli i ekspertve të hartave zonale le ta analizojne mirë le të dal në debat me qytatarët tani pastaj le të vie ky propozim në kuvend.Na nuk jemi per me votu kështu siç është .

Sefer Tasholli,pas vendimit qe do ta marr kuvendi do të dal në diskutim publik do të bisedohet edhe me qytetarët.Kjo do të inkorporohet në kuadër të hartave zonale.Janë mjete të ministrisë të cilat duhet ti shfrytzojme.

Albulena Kelmendi,ne e kemi diskutue edhe ne KPF ,kur është pyet drejtori nga kolegëja asamblesiste cili është interesi i komunës me këtë rrugë?Përgjigja ka qenë me liru qytetin nga ana e automjeteve në veqanti atyre me peshë të madhe për me u ndërtu një unazë e tillë.Por kur vim te shpronsimet është teme delikate dhe duhet me pas kujdes kur ti bëjm.A jo qe po me doket e pa kuptimt një herë le të votohet këtë pastaj ta diskutojmë me qytetarët.Këtu i kemi dy propoyime njëri me ksoto me me të lartë e me shumë shpronstime tjetri me kosoto me të ulët e më pak shpronstime.Ne si grup parlamentar i VV propozojme qe kjo pike të shtyhet.

Daut Azemi,nuk mundemi ne pa e shpallë intersin publik me diskutue me qyterarë sepse kështu është e përcaktuar me ligj.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e dytë sipas rekomandimit të komisionit dhe pas votimitu konstatua se Kuvendi me 17 votat për, 5 kundër dhe 4 apstenime aprovoi këtë:

IV

Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Lipjanit për parcelat P-71409028-0140-12 dhe P-71409028-01984-5

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabanit drejtor i DEZH,i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Nazmi Krasniqi,ne si komision kemi qenë korrekt gjatë punës,ato prona të cilat po ipen duhet të kthehen në gjendjen e më parshme por ato nuk po kthehen.Unë kërkoj qe ato prona të kthehen në gjendjen e më parshme.

Shkelzen Bislimi,une jam kundër dhe do të jem gjithmonë kundër ndarjes së parcelave për gurthyes e sidomos në Gadime.Kërkoj një saqrim nga Drejtori apo nga zyra Ligjore rreth kriterëve,a janë konsultuar me komisionin per miniera dhe minerale gjatë për licencën e shfrytzimit se a mundet dikush me marrë Licencën pa e marrë pronën,apo kriteret janë vendosë qysh i kanë konvenu një kompanie.

Hyra Bytyçi,ne si grup parlamentar i LDK-s i besojmë komisionit,pasi qe është një komision i përfaqësuar nga partitë ploitike shoqria civile,mendojmë qe kan marrë një vendim të drejtë pavarsishtë sfidave.Ne kërkojmë qe gjatë lidhjes së kontratave me këto kompani të kërkojen qe pronat të kthehen në gjendjen e më parshme.

Ramiz Qeriqi,une jam kundër këtij propozim vendimi për shkak se më herët kam qenë pjesë e komisionit kam dahnë dërheqje për shkak se aty e akm pa qe bëhen gjërat sipas dëshirave.Ati duhet me ja dhanë një kohë të caktume për ta kthyer pronën në gjendjen e më parshme.Une do të jem kundër këtij propozimi.

Argjend Tasholli,une mendoj qe këto parcela po ipen kundër vullnetit të qytatarëve Gadimas.Ne ju kemi drejtuar Kryetarit të Komunës me një peticion si dhe Kryesuesit të Kuvednit dhe do ti drejtohem i edhe oraganeve përgjegjëse qe për këto parcela të ketë hetime.Ne kemi kërkuar qe 4 parcelat të cilat e rrethojne gurthyesin në Gadime mos të ipen.Ajo pjesë mund të shfrytzohet për blegtori shetitore skijim dhe aktivitete e të tjera.Ata gurthyes shkaktojnë pluhur por edhe i injorojnë qytetarët e Gadimes dhe juve duke mos i vën as shenjat.Gadimja është një vend turistik e nuk ndërtohet me gurthyes.Kërkesa e qytarëve të Gadimes është qe mos të votohet ky propozim vendim.

Daut Azemi,është dashtë ti me kundërshtu edhe në komision pasi qe ke qenë pjesë e kimisionit.Të gjithë anëtarët e kimsiionit keni votu për e tani po bën thirrje kishe mos e votoni.Po del në kundërshtim me veprimet e tua.

Argjend Tasholli,na kemi bër vlersimin e ofertve dhe çdo herë kam qenë kundër dhe cdo herë do të jem kundër kur është në pyetje qeshtja e Gadimasve.

Daut Azemi,kisha kërku qe te jesh real jo her ashtu her kështu,mos i mashtro qytatarët.

Argjen Tasholli, ne i kemi dërzur peticionin ju nuk e keni pru në seancë.

Daut Azemi,une nuk bi në kuvend peticione të cilat janë kundërshtuar nga qytatarët.

Avni Olluri,më erdh mirë Argjendi qe e pranoi qe e ka dërzur peticionin.

Lulzim Rrustemi,une e respektoj punen e komisionit i cili ka punu ne baze te letrave te ofertes dhe te kriterëve te cilat jane dhanë.Ndërsa vendimet i merr kuvendi.Ne si grup parlamenat i PDK-s nuk e kemi votu më heret dhe nuk do ta votojmë prap.Ne kemi pas një peticion nga qytarët dhe ju nuk e keni pru në Kuvend.

Daut Azemi,kuvedni i merr vendimet po komisioni ka rekomani me ardhe ne kuvend ky propozim mos me pas rekomandu komisioni nuk ish ardh hiç në Kuvend,si rekomadim

Bekim Shabanisa i përket caktimit të kriterëve ky ka qenë rikonskurs dhe ne vetëm e kemi rishpallë.Kthimi në gjendjen e më parshme,komapnitë e kanë mjete të deponume

pranë KPMM –s për kthimin e gjendjen emë parshme.Sa i përket këtyre ankesave nuk kemi pas asnjë ankesë.

Afrim Miftari,gjendja e gurthysve në tër Kosovën është alarmante,po këtu po bëhet fajlë për gurthyes qe janë aty,Eshtë obligim ligjor i kompanive qe të rregullojnë aty ta mbushin me dhe të mbjellin bari.Ata gurthyes aty janë qe një kohë të gjatë jo tani.Ato pjesë duhet të gjelbrohen nga Gurthyesi.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 17 votat për, 9 kundër aprovoi 2 apstenime këtë:

V

Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Lipjanit për parcelat P-71409028-01049-6

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabanit drejtor i DEZH,i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Majlinda Sylejmani,si si grup parlamentar i LDK-s e përkrahim këtë propozim vendim ,ne si komision jemi njoftuar nga ana e kryetarit të komisionot per largimin e një pjese të prone per ti ruajtur disa pisha dhe e kemi mbështetë dhe si të tillë e kemi rekomanduar për kuvend.

Argejd Tasholli,e falnderoj komisionin per bashkpunimin qe kemi pasi ku kemi arrite me largu njeran prej parcelave prej gurthyesve dhe rekomandimi tjetër ndarja e parceles mbrojtja e pishave.Komisioni ka vendos tash i mbetet kuvendit me vendos nese do me vendos per apo kunder.Une i falemnderoj antaret e komisionit për bashkpunimit.

Ramiz Qeriqi,mu me ka zavendesu Argjedni dhe me krenari ja kam leshu vendin se vjen prej atij fshati.Une nuk kam dashtë me qenë pjesë e atij komisioni qe nese femija mi mem than qe çka ke bo?

Lulzim Rustemi,ne si grup parlamentar i PDK-s jemi kundër këtij propozim vendimi. Kam kërkesë qe herat tjera propozimet te vin ma të pregaditura.

Bekim Shabani,komisioni e ka bërë një një punë të shkëlqyshme për të cilën i falemnderoj dhe ne kemi bër rekomandimin e tash kuvendi është ai qe do të vendosë

Lulzim Rustemi,komisioni e jep rekomandimin e vet e ne si kuvend vendosim.

Daut Azemi,komisioni mundet mos me dhane rekomandim me shku ne kuvend.

Meqë diskutime rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 17 votat për, 8 kundër dhe 2 pastenime aprovoi këtë:

Pasi çështje të tjera nuk pati mblledhja përfundoi në ora 15,²⁰

**Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu**

**Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi**

